



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:168055

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05636209

PPP.nr.181/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i përgjithshëm, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit T.K. Sh.A, me seli në Prishtinë, kundër debitorit B.H. nga Ferizaj, rr "...", nr...., për pagesën e borxhit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 29.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit B.H., i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbartimit P.nr.171/22, të datës 18.07.2022, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat P.Xh. nga Gjilani, dhe **MBETET NË FUQI** urdhri mbi lejimin e përmbartimit P.nr.171/22, i datës 18.07.2022.

A r s y e t i m

Me urdhrin P.nr.171/22, të datës 18.07.2022, Përmbartuesi privat P.Xh., e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga kreditori T.K. SH.A, kundër debitorit B.H., për pagesën e borxhit në shumë prej 175 euro, dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 30 euro, në bazë të aktgjykimit C.nr.185/12, të datës 04.12.2014, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, si dhe pagesën e shpenzimeve të përmbartimit, ose bllokimin e të gjitha llogarive bankare të debitorit si dhe regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit dhe nga shuma e fituar nga shitja e sendeve të debitorit të paguhet borxhi i kërkuar nga kreditori.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, me të cilin i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta shfuqizoj urdhrin për përmbarim.

Kreditori në përgjigjen e ushtruar me shkrim në prapësimin e debitorit, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbarim dhe pretendimet në prapësim të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi në fjalë është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71, par 1, të LPP-së.

Gjykata vlerëson se urdhri për përmbarim i lëshuar nga Përmbaruesi privat P.Xh., me numër P.nr.171/22, i datës 18.07.2022, është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmbar shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore, ngase përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori në bazë të nenit 22, par 1, nën par 1.1, të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim se e kontestoj cilësinë e debitorit dhe borxhin në tërësi si inekzistent duke u bazuar se unë kam qenë posedues i nr..... të telefonit fiks, por harxhimet e impulsave të telefonisë nuk i kam bërë, seanca në gjykatë është mbajtur pa prezencën time dhe asnjëherë nuk më është dorëzuar aktgjykimi në mënyrë që të më mundësohet ankimimi në shkallën e dytë të gjykatës për çka mu ka mohuar e drejta në gjykim të drejtë, Gjykata këto pretendime të debitorit i konsideron të pabazuara sepse me rastin e vendosjes lidhur me prapësimin e ushtruar kundër urdhrin për përmbarim, Gjykata nuk ka tagër që ta vlerësoj ligjshmërinë e nxjerrjes së aktgjykimit C.nr.185/12, të datës 04.12.2014, sepse një gjë të tillë mund ta bëjë vetëm Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me rastin e vendosjes lidhur me ankesën eventuale të ushtruar kundër aktgjykimit të cekur më lart. Gjithashtu, edhe sa i përket gjendjes faktike të vërtetuar me aktgjykimin e cekur, Gjykata nuk mund ta vlerësoj aktgjykimin në fjalë edhe sa i përket faktit se si është vërtetuar gjendja faktike rreth shfrytëzimit apo jo të impulsave të telefonit fiks që mban numrin ..., sepse një gjë të tillë siç është përmendur më lart mund ta bëjë dhe është në kompetencë vetëm të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë.

Po ashtu, edhe sa i përket pretendimit të debitorit lidhur me parashkrimin e borxhit, Gjykata konsideron se edhe ky pretendim nuk qëndron dhe është i pabazuar, për faktin se siç vërtetohet nga propozimi për përmbarim, gjegjësisht nga data dhe viti i dorëzimit të propozimit për përmbarim nga kreditori, siç është data 18.07.2022 dhe data dhe viti i plotfuqishmërisë, siç është data 19.03.2015 dhe i ekzekutueshmërisë me datën 19.04.2015, konstatohet se në rastin

konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës së kreditorit dhe nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 361, par 1, i LMD-së, në të cilin është paraparë shprehimisht se: “Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim”.

Gjykata, po ashtu konstaton se kreditori bashkë me propozimin për përmbarim, tek përmbaruesi privat e ka dorëzuar edhe aktgjykimin C.nr.185/12, të datës 04.12.2014, në origjinal të tij dhe i cili është i pajisur edhe me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri, respektivisht aktgjykimi është i plotfuqishëm më datën 19.03.2015 dhe i ekzekutueshëm me datën 19.04.2015, dhe kështu në këtë rast janë respektuar në tërësi dispozitat e nenit 36, par 1, të LPP-së.

Përveç tjerash, Gjykata konstaton se aktgjykimi i cekur më lart është në tërësi i përshtatshëm për përmbarim dhe në pajtim me nenin 27, par 1, të LPP-së, pasi që në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, mjetet, shuma e cila është prej 175 euro dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 30 euro dhe koha e përmbarjes se detyrimit, siç është afati prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Andaj, Gjykata duke i marr parasysh thëniet e debitorit në prapësim, përgjigjen me shkrim të kreditorit në prapësimin e debitorit, provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe vendosi që të njëjtin ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar ndërsa urdhri për përmbarim P.nr.171/22, i datës 18.07.2022, të mbetet në fuqi.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.181/22, më datë 29.04.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.